

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin individual Ilir Bytyqi dhe me sekretaren juridike Vildane Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarve K.M., N.M. dhe V.A., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i letë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nenpar. 1.1 dhe nenit 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1744-7/16 të dt. 18.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani, të pandehurve K.M., N.M. dhe V. si dhe të dëmtuarve A.B. dhe Y.B., me datë 26 Tetor 2016 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 04 Nëntor 2016, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit: 1. K.M. data e lindjes...., nga i ati M. dhe nëna F. e gjinisë N., me vendbanim në Fsh. K. Ferizaj, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike.

2. N.M. data e lindejs....., nga i ati M. dhe nëna F. e gjinisë N., me vendbanim në Fsh. K. Ferizaj, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike.

3. V.R. Data e lindjes..., nga i ati A. dhe nëna D. e gjinisë Sh., me vendbanim në Fsh. K. Ferizaj, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike.

JANË FAJTOR

Sepse me datë 27.09.2016, rreth orës 19:50, në rrugë “Ahmet Kaçiku” në oborrin e stacionit të Autobusëve në Ferizaj, të pandehurit K.M., N.M. dhe V., për shkak të një konflikti rreth një femre i kishin sulmuar fillimisht me grushte dhe shqelma të dëmtuarit A.B. e Y.B., ashtu që vije dhe ndërhyrës i pandehuri K.M. me një mjet të mbrehet (thikë), i ka sulmuar fizikisht të dëmtuarit duke i goditur në kokë dhe shpinë, të cilët kanë marrë lëndime trupore të përshkruar në ekspertizë mjekësore të dt. 04.10.2016.

me të cilën kreu veprën penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 dhe neni 31 të KPRK-së.

Andaj, në bazë neni 188 par.2 lidhur me par. 1 nën par. 1.1 dhe neneve 4, 7, 17, 23, 31, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75, 76 të KPRK-ës, dhe neni 365 të KPPK-së, i

G J Y K O N

Të pandehurin: K.M. me DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 6 /gjashtë/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Të pandehurin: N.M. me DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 4 /katër/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Të pandehurin: V.R. me DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 6 /gjashtë/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Në dënimin e shqiptuar si më lart i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 27.09.2016 deri me datën 26.10.2016.

Konform nenit 115 par 2 nenpar. 2.1 të KPRK-së, konfiskohet ne mënyrë te përhershme: thika e cila është e identifikuar si dëshmi D#1.

Obligohen të pandehurit që në mënyrë solidare në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 60 /gjashtëdhjetë/ €, si dhe shpenzimet e procedurës penale ne shumën prej 20 /njëzetë/ € në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Të dëmtuari, A.B. dhe Y.B. nga Fsh. K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet ne procedure kontestimore.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën të evidentuar PP/II.nr.1744-7/16 të dt. 18.10.2016, ka ngarkuar të pandehurit K.M., N.M. dhe V.R., për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nen par. 1.4 të KPRK-së, me qëndrim se mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që të pandehurit të shpallet fajtorë dhe te i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është ne kompetencën lëndore dhe territoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26 Tetor 2016, në të cilën shqyrtim gjyqësor të akuzuarit kanë deklaruar:

1. K.M. ndihem fajtor për veprën për të cilën më ngarkon akuza si dhe jam i vetëdijshëm prej pasojat e pranim te fajësisë, jam i penduar thellë për veprën penale, ju kërkoj falje publike te dëmtuarve, si dhe premtoj premtojë që në te ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, i propozoj gjykatës të më shqiptoj dënim sa me te butë.

Av. mbrojtës i te pandehurit K.M., Av. E.H.V. ne lidhje me pranimin e fajësisë deklaron: mbështes pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im, pranimi i bere krejtësisht ne mënyre vullnetare, pas konsultimeve te mjaftueshme me mua si mbrojtëse, pranimi i fajësisë përputhet me shkresat e lendes, i mbrojturi im është penduar thelle për veprimet për te cilat i ka shkaktuar lëndim te lehte trupor te dëmtuarve si dhe i propozoj gjykatës ti ketë parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese.

2. Ne lidhje me pranimin e fajësisë i pandehuri N.M. deklaron: ndihem fajtor për veprën për të cilën më ngarkon akuza si dhe jam i vetëdijshëm prej pasojat e pranim te fajësisë, jam i penduar thellë për veprën penale, ju kërkoj falje publike te dëmtuarve, si dhe premtoj premtojë që në te ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, i propozoj gjykatës të më shqiptoj dënim sa me te butë.

Av. mbrojtës i te pandehurit N.M., Av. I.Q. ne lidhje me pranimin e fajësisë deklaron: i mbrojturi im denjësisht është penduar për veprimet e kryera, njeherit palëve te dëmtuara ju kërkon falje si dhe ju premtion se gjera te tilla nuk do te ndodhin, si dhe i propozoj gjykatës te pandehurit ti shqiptoj një dënim sa me te bute.

3. Ne lidhje me pranimin e fajësisë i pandehuri V. deklaron: ndihem fajtor për veprën për të cilën më ngarkon akuza si dhe jam i vetëdijshëm prej pasojat e pranim te fajësisë, jam i penduar thellë për veprën penale, ju kërkoj falje publike te dëmtuarve, si dhe premtoj premtojë që në te ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, i propozoj gjykatës të më shqiptoj dënim sa me te butë.

Av. mbrojtës i te pandehurit V., Av. G.R. ne lidhje me pranimin e fajësisë deklaron: meqenëse se klienti im është penduar thelle për veprimet e tij, si dhe i ka premtuar gjykatës qe nuk do te përsërisë vepra te tilla, meqenëse është hera e pare qe ndeshet me ligjin i propozoj gjykatës qe gjate matjes se dënimit ti shqiptoj një dënim sa me te bute, duke marr parasysh qe i mbrojturi im ka pranuar fajësinë si ne polici po ashtu edhe ne gjykate.

Prokurori i shteti Ismet Rrahmani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht: mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore, mendimi dhe konstatimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko- ligjor i dt.04.10.2016, thika me nr. te dëshmisë D1, zinxhiri i ruajtjes i dt. 27.09.2016, deklarata e të dëmtuarit A.B. i dt. 18.10.2016 si dhe dt.27.09.2016, deklarata e te dëmtuarit Y.B. i dt. 18.10.2016 si dhe dt.27.09.2016, deklarata e dëshmitares E.I. e dt. 18.10.2016, pjesërisht deklaratat e te pandehurve K.M., N.M. dhe V. te dhënë ne hetuesi, raportet e qendrës emergjente ne Ferizaj me nr. protokolli1987 dhe 1984 i dt. 27.09.2016 dhe 2002 si dhe fotografit te cilat gjenden ne shkresat e lendes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se te akuzuarit kane pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale 188 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.1 dhe nenint 31 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi te akuzuarit me dashje direkte rreth një konflikti për shkak te

një femre, fillimisht i kishin sulmuar me grushta dhe shkelma te dëmtuarit, ku me pas i pandehuri K.M. me një mjet te mprehtë (thike) i ka sulmuar te dëmtuarit duke i goditur ne koke dhe shpine, ku si pasoje e kësaj te dëmtuarit kane marr lëndime trupore te përshkruar ne ekspertizën mjekoligjore te dt. 04.10.2016.

Nga interpretimi dispozitës te nenin 188 arrihet në përfundimin se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik, të personit, cenimi i të cilit pas sjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që të kenë prekur shëndetin e personit, konkretisht funksionimin normal të trupit të të dëmtuarit, duke i sjelle atij paaftësi te përkohshme. Në rastin konkret veprimet e dhunës duhet të sjellin si pasojë cënimin e integritetit fizik, psikosocial e ekonomik, rrethanë kjo cilësuese e veprës penale. Me integritet fizik do të kuptohet e drejta dhe mundësia që ka një person për të zotëruar dhe kontrolluar vetë trupin e tij dhe për t'u ndier i sigurtë nga çdo formë e dhunës.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese përkatësisht që në fillim te shqyrtimit kryesor ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer e që këto rrethana i ndërlidhi me faktin se i akuzuari deri tani nuk ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se te akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, Obligohen të pandehurit që në mënyrë solidare në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 60 /gjashtëdhjetë/ €, si dhe

shpenzimet e procedurës penale ne shumën prej 20 /njëzetë/ € në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.991/16, me datë 04.11.2016.**

**Sekretare Juridike,
Vildane Azemi**

**Gjyqtari Individual,
Ilir BYTYQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.